

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL**, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.H. nga P. rruga “...” pn., për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1.pika 1.lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.6845-11/2011 dt.27.03.2012, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të datës 20.02.2015, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore nga Prishtina-Ibrahim Fejza të dëmtuarit F. B. ,të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari R. H.**, i biri i H. dhe H. e gjinisë H., i lindur më *data e lindjes...*, në P., ku edhe banon në rrugën “...” pn, me nr. Personal *numër personal...*, i martuar baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-rast social, më parë ka qenë i gjykuar për vepër të njëjtë penale, kundër tij zhvillohen procedura tjera penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### Sepse:

Me dt.27.08.2010, rreth orës 04:30 min, në fshatin Sallabajë të Podujevës, saktësisht në shitoren NTP ”F.C.”, pronë e të dëmtuarit F. B., të pandehurit në bashkëveprim me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj të luajtshme, kanë shkuar në lokalin e të dëmtuarit dhe me përdorimin e forcës, me mjete të përshtatshëm, - kaçavidë kanë hapur derën ndihmëse te lokalit në fjalë nga pjesa e brendshme e oborrit të shtëpisë ku gjendej lokali, kanë depërtuar brenda në lokal dhe i pandehuri R. afër derës ka bërë roje ndërsa i pandehuri F. ka mbushur një qese me 300 pako të cigareve të llojeve të ndryshme, pastaj me veturën e tipit “Ford” ngjyrë e bardhë të cilën e ka drejtuar i pandehuri R. janë larguar nga vendi i ngjarjes, me ç ‘rast te dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

Me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, dhe në bazë të nenit 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e,

## **G J Y K O N**

I.Të akuzuarin **R. (H.) H.**, me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej një (1) vjet e gjashtë (6) muaj, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.I dëmtuari F.B., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

III.Konform nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të akuzuarit pasi që i njëjti merr ndihmë sociale.

## **A r s y e t i m**

PPK-në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.1773-12/2009 dt.03.06.2009, kundër të akuzuarve: F.Sh. dhe R. H., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1.pika 1.lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale Gjukata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 19.02.2015 dhe, 20.02.2015, në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit, dhe të akuzuarit.

Gjukata në shqyrtimin fillestar të datës 19.02.2015, me aktvendim të veçantë e ka veçuar procedurën për të akuzuarin F.Sh. pasi që nga informata e Stacionit Policor në Podujevë të datës 13.02.2015, thuhet se i akuzuari gjendet në Gjermani.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar, ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës, duke shtuar se ndien vetën të fajshëm, pendohet dhe i premtot gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestarë dhe lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, duke konsideruar se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjukata vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e

çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar edhe nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën penale me dashje, me paramendim, sepse ka qenë të vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit R.H., përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ishte penduar, ishte korrekt gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti si i akuzuari është gjykuar edhe më parë për të njëjtën veprë penale dhe zhvillohen edhe procedura tjera penale, rrethana tjera rënduese janë shkalla e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur e që është prona private, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale është shqetësuese, ku është krijuar një pasiguri e madhe e shoqërisë në Kosovë, se ky lloj i veprave penale është bërë dukuri e shpeshtë në vendin tonë, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbajnë pasi aktgjykim të merr formën e prerë, dhe konsideroi se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe përgjegjësisë penale dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tyre dhe si masë parandaluese me efekt në persona të tjerë për moskryerjen e veprave penale të parapara sipas dispozitës së nenit 34 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që nuk ka pasur prova për të vendosur në këtë çështje penale juridike.

Duke u bazuar në nenin nenit 453 par.4 të KPPRK-së, gjykata e liron të akuzuarin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ngase pagesa e tyre do ta rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit pasi që i njëjti merr ndihmë sociale bazuar në kopjen e Kartelës për Ndhmë Sociale me nr. të regj.1801413 dhe nr. ID .... të datës 29.09.2014.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL  
PKa.nr.79/12, dt.20.02.2015**

**Sekretarja Juridike  
Mihrie Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Gazmend Bahtiri**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.